



Republika e Kosovës/Republika Kosova / Republic of Kosovo

Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/ Ministarsvo Trgovine Industrije/ Ministry of Trade
and Industry*

SHKËMBIMET TREGTARE TË KOSOVËS

2022

Departamenti i Tregtisë - Divizioni i Politikave Tregtare

Mars 2023

Tabela e Përmbajtjes

Ekonomia e Kosovës dhe sektori i jashtëm

- ⇒ Vështrim i përgjithshëm
- ⇒ Vlerat e tregtisë së mallrave në Kosovë
- ⇒ Rrjedha gjeografike e tregtisë
- ⇒ Tregtia me vendet e BE-s
- ⇒ Tregtia me vendet e CEFTA-s
- ⇒ Tregtia e mallrave – produktet e eksportuara dhe importuara
- ⇒ Përbërja e tregtisë së mallrave
- ⇒ Tregtia Globale
- ⇒ Indeksi i varësisë tregtare
- ⇒ Indeksi i tendencës së eksporteve
- ⇒ Indeksi i mbulimit të eksportit/importit
- ⇒ Pengesat strukturore

Ekonomia e Kosovës dhe sektori i jashtëm

- **Vështrim i përgjithshëm**

Ekonomia globale e ndodhur në përballje me presione të rritura inflacioniste si pasojë e ndërprerjeve të vazhdueshme në zingjirët furnizues që nga pandemia dhe së fundmi pasojave ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga fillimi i luftës në Ukrainë, ndaj të cilëve Kosova është e ekspozuar, andaj për pasojë të tërë kësaj, aktiviteti ekonomik në Kosovë gjatë vitit 2022 u zhvillua në një ambient më pak të favorshëm makroekonomik.

Aktiviteti ekonomik në Kosovë, sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shënoi rritje reale prej 2.07 % në TM3 2022 (BQK), ndërsa për vitin 2022 projeksionet e BQK sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënojë rritje prej 3%. Ngadalësimi i rritjes së aktivitetit ekonomik pritet të jetë i ndikuar nga rritja më e ulët e kërkesës së brendshme.

Lufta në Ukrainë ka ndikuar në rritjen e rreziqeve për perspektivën ekonomike dhe ndikimi i kësaj krize është reflektuar në rritje të vazhdueshme të çmimeve të energjisë, naftës dhe ushqimit, me efekte negative në besueshmërinë e konsumatorëve dhe fuqinë blerëse. Rritja relativisht e lartë e çmimeve globale të inputeve të ndërmjetme dhe energjisë ka ndikuar që Kosova me rastin e importit të mallrave të importoj edhe inflacionin. Kjo rritje e inflacionit përkethehet me rritjen enorme të çmimeve të shumë produkteve ushqimore në Kosovë. Norma mesatare vjetore e inflacionit për vitin 2022 është 11.6%, thuhet në raportin e fundit i Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Presionet e inflacionit në vendet e eurozonës, rajon ky më të cilin Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare, u reflektuan edhe në ekonominë e vendit. Gjatë këtij viti ekonomia e Kosovës u reflektua nga rritja e çmimeve të produkteve të importuara e në veçanti rritjes së çmimeve të derivateve të naftës të cilat gjithashtu kanë ndikuar edhe në koston e prodhimit në vend.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) në Kosovë u ngritën në një mesatare vjetore prej 9.3%. Ngritje më të mëdha, sipas degëve të veprimtarive ekonomike, kanë qenë te përpunimi i produkteve ushqimore. Andaj zhvillimet në nivelin e çmimeve në vend vazhdojnë të përcaktohen nga lëvizja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së vendit në importe gjë që konfirmohet edhe me sjelljen e ngjashme të indeksit të çmimeve të konsumit me indeksin e çmimeve të importit.

Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK) tregon për zgjerim të bazës së inflacionit, ku pjesa më e madhe e shportës së konsumit (80% e shportës) shënoi rritje të çmimeve. Kështu që (IÇK) shënoi rritje me një mesatare vjetore prej 11.6%. Ndikimi i ekonomisë së Kosovës nga lëvizja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare po ashtu u pasqyrua në rritjen e indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) i cili në TM1 2022 arriti në 21.8%, në TM2 2022 në 23.3 % , në TM3 2022 në 17.5 % dhe në TM4 ne 13%, mesatarja vjetore 18.7% .

Përkitazi me këto të dhëna faktori kontribuues në rritjen e vlerës së importit është rritja e çmimeve në tregun ndërkombëtarë ku importi është ekspozuar tërësisht ndaj rritjes së çmimeve teksa në anën tjetër kemi rënie të importit sipas vëllimit/sasisë.

- **Tendencat në Tregtinë e Mallrave**

Vlerat e tregtisë së mallrave - Kosova gjatë vitit 2022 kishte një deficit tregtar që arrin shifrën prej 4.7 miliardë €. Ky deficit tregtar ka shënuar rritje për afërsisht 800 milion € nga viti 2021 gjë që vazhdimisht na tregon një debalancë të lartë tregtarë.


Mallrat e eksportuara arritën vlerën prej 920.4 milion € (rritje për 164.6 milion €) ose 22% më e lartë se sa gjatë vitit 2021. Ndërsa importet shënuan vlerën prej mbi 5.6 miliard € (rreth 955.1milion € më e lartë) konkretisht rritje për 20.4%.

Gjatë dy dekadave të fundit tregtia e jashtme e mallrave ka shënuar rritje signifikante, duke u rritur nga 1.2 miliardë € sa ishte në 2005 në më shumë se 2.9 miliardë € në 2015, në vitin 2021 ishte 5.4 miliardë € dhe në vitin 2022 ishte 6.5 miliard € (Figura 1).

Tabela 1: Bilanci tregtare (në 000 €)

Indikator/Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Diferenca (€)	↓↑, % 22/21
Eksporti	325,294	309,627	378,010	367,500	383,491	474,884	755,726	920,405	164,679	21.8%
Importi	2,634,693	2,789,491	3,047,018	3,347,007	3,496,942	3,296,635	4,684,198	5,639,393	955,195	20.4%
Bilanci tregtar	-2,309,399	-2,479,864	-2,669,008	-2,979,507	-3,113,451	-2,821,751	-3,928,472	-4,718,989	-790,516	20.1%

Figura 1: Tregtia e jashtme e mallrave 2005 – 2022



- **Rrjedha gjeografike e tregtisë**

Tregtia me vendet e BE-së dhe me vendeve e rajonit pjesëmarrëse në CEFTA përbën pjesën më të rëndësishme të integrimit tregtarë të Kosovës, diku me rreth 67% të gjithë tregtisë së jashtme.

Gjatë vitit 2022 Kosova e ka rritur, për një nuancë, integrimin me vendet tjera jashtë bllokut të CEFTA-s dhe BE-s. Pra, aktualisht përfaqësimi i vendeve jashtë këtyre rajoneve në strukturën e përgjithshme të partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës është ndryshuar. Integrimi i tregtisë me vendet jashtë rajonit megjithatë është bërë me tepër në favor të importit nga këto vende në Kosovë dhe jo aq në favor të eksportit nga Kosova për në vendet jashtë rajonit.

Prandaj sa i përket integrimit me vendet jashtë bllokut të BE-s dhe CEFTA-s rritja e importit është kryesisht nga Turqia, Kina dhe veçanërisht Arabia Saudite (është rritur vlera e importit për 149.3 milion € në raport me vitin paraprak 2021). Mallrat e importuara nga këto vende mbulojnë 28.5% të importeve të përgjithshme të Kosovës. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup janë: Turqia (14.9%), Kina (9.7%) si dhe Arabia Saudite 3.9% pjesëmarrje në importet e përgjithshme në Kosovë të cilët njëkohësisht edhe prijnë në top vendet më importuese të Kosovës.

Figura 2: Top vendet për importin e përgjithshëm ne Kosove 2022





Figura 3: Top vendet për eksportin e përgjithshëm te Kosovës 2022



Ndërsa, sa i përket eksportit të mallrave ato kanë pasur një ndryshim të partnerëve tregtar, veçanërisht kur është fjala për partnerin kryesor për eksport në eksportin e përgjithshëm të Kosovës. Vlen të theksohet se gjatë viteve 2021/2022 partneri kryesor i Kosovës ka qenë SHBA ku 15% e vlerës së përgjithshme të eksportit si destinacion ka pasur tregjet e SHBA, (eksporti i dyshekëve). Megjithatë blloku i vendeve anëtare në CEFTA dhe BE ende vazhdojnë të jenë partnere kryesore tregtare. Mallrat kosovare të cilat eksportohen në vendet e CEFTA-s arrin vlerën prej 333.5 milion € nga e cila mbulohet 36% e eksporteve të përgjithshme. Kurse eksportet drejt tregjeve të BE kanë arritur vlerën prej 311.7 milion € ose 34% e totalit të eksporteve. Në terma absolut eksportet në vendet e CEFTA-s dhe në vendet e BE-s kanë shënuar rritje, ndërsa partnerët kryesorë për importin e mallrave në Kosovë janë vendet e BE-s. Nga vendet e CEFTA aktualisht Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria janë ndër dhjetë importuesit më të mëdhenj (për më shumë shih Tabelën 2).

Tabela 2: Partneret kryesor ne importin e përgjithshëm 2021 – 2022 (në milion €)

Partneri	Importi 2021	Renditja	% total	Importi 2022	Renditja	% total	Ndryshimi (%) 2022/2021
Turqia	587.5	2	12.5%	843.0	1	14.9%	43.5%
Gjermania	611.4	1	13.1%	610.4	2	10.8%	-0.2%
Kina	452.3	3	9.7%	548.6	3	9.7%	21.3%
Serbia	306.4	4	6.5%	372.1	4	6.6%	21.4%
Greqia	205.3	8	4.4%	307.3	5	5.5%	49.7%
Maqedonia	242.8	7	5.2%	282.1	6	5.0%	16.2%
Italia	276.4	5	5.9%	275.9	7	4.9%	-0.2%
Shqipëria	266.9	6	5.7%	255.9	8	4.5%	-4.1%
Sllovenia	178.6	9	3.8%	243.6	9	4.3%	36.4%
Arabia Saudite	72.0	15	1.5%	218.1	10	3.9%	202.7%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Një pjesë tjetër e konsiderueshme e eksporteve shkon drejt vendeve me të cilat Kosova ka ndonjë marrëveshje tregtare ose përfitues i masave preferenciale.

Në tabelën nr. 3 vërehen ndryshimet që kanë pësuar 10 partnerët kryesorë të eksportit. SHBA është partneri kryesor sa i përket eksporteve të Kosovës apo 136.5 milion € vlera eksporti, ndryshimi i eksportit nga viti 2021 në vitin 2022 është 10.6% më i lartë.

Tabela 3: Partneret kryesor ne eksportet e përgjithshëm 2021-2022 (në milion €)

Partner	Eksporti 2021	Renditja	% total	Eksporti 2022	Renditja	% total	Ndryshimi (%) 2021/2022
SHBA	123.4	1	16.3%	136.5	1	14.8%	10.6%
Maqedonia	87.0	3	11.5%	119.1	2	12.9%	36.9%
Shqipëria	111.3	2	14.7%	102.0	3	11.1%	-8.4%
Gjermania	61.8	4	8.2%	87.8	4	9.5%	42.1%
Zvicra	56.2	6	7.4%	70.1	5	7.6%	24.8%
Serbia	44.3	7	5.9%	62.9	6	6.8%	42.1%
Italia	60.2	5	8.0%	46.4	7	5.0%	-23.0%
Mali Zi	24.6	8	3.3%	38.3	8	4.2%	55.5%
Sllovenia	9.5	17	1.3%	29.7	9	3.2%	212.9%
Holanda	20.5	9	2.7%	29.1	10	3.2%	41.8%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

- **Tregtia me vendet e BE-s**

Shkëmbimet tregtare të Kosovës me vendet e BE-s arritën vlerën prej 2.7 miliard €, kështu që 41% e shkëmbimeve tregtare të Kosovës, gjatë vitit 2022, janë realizuara me vendet e BE-s. Pra kjo do të thotë se, sa i përket eksporteve, një pjesë e madhe e mallrave të eksportuara (pas CEFTA) kanë shkuar drejt tregjeve të BE-s duke arritur vlerën në 311.8 milion € ose 34% e totalit të eksporteve me një rritje prej 31% (Tabela 4).


Tabela.4: Bilanci tregtar me vendet e BE

Indikatorët/ viti	2021	2022	Diferenca (Euro)	↑↓% 2022/2021	% share in total 2021	% share in total 2022
Eksporti	237,747,099	311,767,581	74,020,481	31.1%	31.5%	33.8%
Importi	2,004,169,894	2,388,797,997	384,628,103	19.2%	42.7%	42.3%
Bilanci tregtar	-1,766,422,794	-2,077,030,416	-310,607,622	17.6%		

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT


Për me tepër mund të konsiderojmë që vendet me të rëndësishme për eksportin vendor nga blloku i vendeve të BE-s janë: Gjermania, Italia, Sllovenia dhe Holanda, (Fig4). Sa i përket strukturës së eksporteve dedikuar tregjeve të BE-s, kryesisht janë mallra që i përkasin sektorit të plastikës pasuar nga sektori i mineraleve si dhe metaleve bazë dhe artikujt prej tyre, (Tab:7).

Figura 4: Top vendet eksportuese ne BE 2022



Ndërsa, importet nga vendet e BE-s arritën në vlerë prej mbi 2.3 miliard euro, rritje prej 19%. Pjesa më e madhe e mallrave të importuara janë nga vendet e BE-s (mbulon 42% e importeve të përgjithshme). Kosova importon mallra kryesisht nga Gjermania, Greqia, Italia, Sllovenia dhe Polonia, (Figura 5).

Figura 5: Top vendet importuese nga BE 2022



Vlerat e indeksit të paraqitura ndër vite tregojnë se eksporti i mallrave bujqësore me origjinë nga Kosova në drejtim të BE-s ka shënuar rritje. Por ajo që vlen të theksohet është se raporti i strukturës së mallrave për eksport është mjaft i shthurur: mallra industriale 87% (jo-ushqimore) kurse mallrat me përbërje bujqësore, industriale ushqimore dhe pijeve 13% , (Tabela 5 dhe 6).

Tabela 5: Eksporti i produkteve bujqësore në BE 2021-2022

Seksionet produkteve bujqësore /Viti	2021 (€)	2022 (€)	Diferenca	↓↑, 2022/21
Kafsha te gjalla produkte me origjinë kafshe	10,151	32	-10,119	-99.7%
Produkte bimore	14,559,052	16,638,244	2,079,193	14.3%
Yndyrëra	276,682	891,337	614,655	222.2%
Ushqimet te përgatitura, pije dhe duhan	17,248,111	24,469,135	7,221,024	41.9%
Total	32,093,995	41,998,748	9,904,753	30.9%

Nga ecuria e viteve të mëparshme kuptojmë se prodhimet e produkteve bujqësore do të kenë potencial indikativ për eksport më të shtuar në BE. Potenciali është akoma më i madh dhe i qëndrueshëm për specializim dhe rritje të konkurruesmërisë, me anë të konsolidimit të zinxhirit të vlerës nëpërmjet shkëmbimeve ndër-sektoriale.

Duke iu referuar Tabelës nr. 6 të eksporteve për produkte industriale/jo ushqimore në BE mund të vërehet se produktet nga plastika dominojnë si sektori më eksportues në drejtim të vendeve të BE me rreth 79.6 milion € në vitin 2022 pasuar nga mineralet me vlerë eksportuese 2.5 milion € dhe metale bazë dhe artikuj prej tyre me 41.8 milion €. Totali i eksporteve të produkteve industriale me vendet e BE-s në vitin 2022 është 269.7 milion €, rritje prej 31% në raport me vitin 2021.

Tabela 6: Eksporti i produkteve industriale në BE 2021-2022

Sektori produkteve industriale / Viti	2021 (€)	2022 (€)	Diferenca (€)	↓↑, 2022/21 (%)
Produkte minerale	14,895,470	52,517,058	37,621,588	252.6%
Produkte te industrisë kimike	8,774,222	11,239,143	2,464,921	28.1%
Plastik gome dhe artikujt prej tyre	45,384,053	79,628,856	34,244,803	75.5%
Lëkure dhe artikujt prej tyre	3,258,387	4,431,552	1,173,165	36.0%
Druri dhe artikujt prej druri	3,626,812	6,017,234	2,390,421	65.9%
Letër dhe artikujt prej letre	1,074,943	1,902,030	827,087	76.9%
Tekstil dhe artikuj tekstili	6,296,704	9,264,880	2,968,175	47.15
Veshmbathje të këmbëve	2,675,103	2,961,175	286,072	10.7%
Art prej guri allçie prod qeramike dhe qelqi	4,552,597	9,702,734	5,150,137	113.1%
Perla gurë te çmuar metale te çmuara etj.	3,937,202	8,053,583	4,116,380	104.6%
Metale baze dhe artikujt prej tyre	80,369,430	41,836,889	-38,532,541	-47.9%
Makineri pajisje mekanike dhe elektrike	12,691,772	9,176,914	-3,514,858	-27.7%
Mjete e transportit	3,156,270	5,451,429	2,295,159	72.7%
Inst optike mjekësore fotog muzikore etj.	294,409	1,819,589	1,525,180	518.0%
Armët dhe municioni	0	0	0	#DIV/0!
Artikujt te ndryshëm te prodhuar	14,547,295	25,523,779	10,976,484	75.5%
Veprat e artit	118,435	241,990	123,556	104.3%
Total	205,653,105	269,768,834	64,115,729	31.2%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura shkëmbimet tregtare eksport/import për vitin 2022 të ndara sipas seksioneve në mes të Kosovës dhe vendeve të BE. Vërehet deficit tregtar në pothuajse në të gjithë sektorët e produkteve, si ato bujqësore po ashtu edhe në ato industriale.

Tabela 7: Shkëmbimet Tregtare të Kosovës dhe BE - seksionet (2022 në milion euro)

Seksionet/Indikator	Eksport	Import	Bilanci Tregtar
1 Kafshë të gjalla produkte me origjinë kafshe	0.0	145.6	-145.6
2 Produkte bimore	16.6	57.7	-41.1
3 Yndyrëra	0.9	22.5	-21.6
4 Ushqimet të perg pije dhe duhan	24.5	343.2	-318.8
5 Produkte minerale	52.5	446.2	-393.7
6 Produkte të industrisë kimike	11.2	242.9	-231.6
7 Plastik gome dhe artikujt prej tyre	79.6	173.3	-93.7
8 Lëkurë dhe artikuj prej tyre	4.4	1.5	2.9
9 Druri dhe artikujt prej druri	6.0	48.2	-42.2
10 Letër dhe artikujt prej letre	1.9	30.0	-28.1
11 Tekstil dhe artikuj tekstili	9.3	17.6	-8.3
12 Veshmbathje të këmbëve	3.0	4.0	-1.1
13 Art prej guri allçie prod qeramike, qelqi	9.7	100.7	-91.0
14 Perla gurë të çmuar metale të çmuara	8.1	1.7	6.4
15 Metale bazë dhe artikujt prej tyre	41.8	123.0	-81.1
16 Makineri pajisje mekanike dhe elektrike	9.2	216.7	-207.6
17. Mjete e transportit	5.5	348.4	-343.0
18 Inst optike mjekësore fotog muzikore etj.	1.8	26.9	-25.1
19 Armët dhe municioni	0.0	5.2	-5.2
20 Artikujt të ndryshëm të prodhuar	25.5	31.6	-6.1
21 Veprat e artit	0.2	1.8	-1.6
Total	311.8	2,388.8	-2,077

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

• Tregtia me vendet e CEFTA-s

CEFTA është një partner i rëndësishëm tregtar e cila mbulon 20% të shkëmbimit të përgjithshëm tregtare të Kosovës. Mallrat kosovare të cilët eksportohen në vendet e CEFTA-s arrijnë vlerën prej 333.5 milion € e cila mbulon 36% të eksporteve të përgjithshme, rritje prej afër 20%.

Importet nga vendet e CEFTA janë mbi 1 miliard € rritje prej 12% dhe mbulon afër 18% të importeve totale në Kosovë (tabela 8).

Tabela 8: Bilanci tregtar me vendet CEFTA

Indikatorët/ viti	2021	2022	Diferenca (Euro)	↑↓% 2022/2021	% share in total 2021	% share in total 2022
Eksporti	278,442,934	333,570,616	55,127,682	19.8%	36.8%	36.2%
Importi	892,584,595	1,000,652,965	108,068,370	12.1%	19.1%	17.7%
Bilanci tregtar	-614,141,661	-667,082,349	-52,940,687	8.6%		

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Partnerë importues kryesor të Kosovës në kuadër të CEFTA-s janë Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria. Vlera e importuar nga këto tri shtete arrijnë 910 milion € apo 91% e totalit të importeve nga blloku i vendeve të CEFTA-s.

Në tabelën nr. 9 është paraqitur ecuria e importeve nga vendet e CEFTA-s ku të dhënat tregojnë se Serbia ka shënuar rritjen më të lartë, në vlerë prej 65.7 milion € apo 21% më tepër importe se sa në vitin 2021.

Po ashtu Shqipëria dhe Maqedonia janë partnerët importues kryesor në importet e përgjithshme të Kosovës.

Tabela 9: Importet nga vendet e CEFTA (milion, euro)

Country	Value 2021	Value 2022	Diferenca 2022/2021	↓↑%, 2022/21	Total Share 2021 (%)	Total Share 2022 (%)	CEFTA Share 2021 (%)	CEFTA Share 2022(%)
Albania	266.9	255.9	-11.0	-4.1%	5.7%	4.5%	30%	25.6%
Bosnia Herzegovina	51.2	66.1	14.9	29.1%	1.1%	1.2%	6%	6.6%
Moldavia	0.3	0.5	0.2	91.3%	0.0%	0.0%	0%	0.0%
Montenegro	25.1	24.1	-1.1	-4.2%	0.5%	0.4%	3%	2.4%
Macedonia	242.8	282.1	39.3	16.2%	5.2%	5.0%	27%	28.2%
Serbia	306.4	372.1	65.7	21.4%	6.5%	6.6%	34%	37.2%
Total	892.6	1,000.7	108.1	12.1%	19.0%	17.7%	100%	100.0%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Për dallim nga importet, eksportet në vendet e CEFTA-s nuk kanë pësuar ndryshim të madh me vendet në të cilat Kosova ka eksportuar brenda këtij blloku. Maqedonia mbetet partneri kryesor sa i përket eksporteve gjatë vitit 2022, ku janë eksportuar rreth 119 milion € apo 36% e totalit të eksportit në CEFTA ose afër 13% e eksportit të përgjithshëm të Kosovës. Po ashtu partneri tjetër kryesor në kuadër të CEFTA është Shqipëria, ku janë eksportuar rreth 102 milion € apo 31% të total eksportit me CEFTA ose 11% të eksportit të përgjithshëm të Kosovës. Serbia përveç që është njeri ndër partnerët kryesor importues është edhe njëri ndër partner kryesor eksportues, si partner i eksportit është në vendin e 3-të në bllokun e CEFTA, ku janë eksportuar rreth 63 milion € apo 19% e totalit të eksportit në vendet CEFTA si dhe 6.8% pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm të Kosovës, (tabela 9).

Tabela 9: Eksportet ne vendet CEFTA (mil, euro)

Country	Value 2021	Value 2022	Diferenca 2021/2022	↓↑%, 2022/21	Total Share 2021(%)	Total Share 2022 (%)	CEFTA Share 2021 (%)	CEFTA Share 2022 (%)
Albania	111.3	102.0	-9.4	-8.4%	14.7%	11.1%	40%	31%
Bosnia & Herzegovina	11.2	11.4	0.1	0.9%	1.5%	1.2%	4%	3%
Moldavia	0.0	0.0	0.0	40.4%	0.0%	0.0%	0%	0%
Montenegro	24.6	38.3	13.7	55.5%	3.3%	4.2%	9%	11%
Macedonia	87.0	119.1	32.1	36.9%	11.5%	12.9%	31%	36%
Serbia	44.3	62.9	18.6	42.1%	5.9%	6.8%	16%	19%
Total CEFTA	278.4	333.6	55.1	19.8%	36.8%	36.2%	100%	100%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Gjatë analizave statistikore, përqendruar kryesisht në produktet bujqësore, është kuptuar se edhe në vitin 2022 kemi një rritje të eksporteve dedikuar tregjeve të CEFTA-s. Raporti i strukture së mallrave të Kosovës me orientim në këto tregje tregon se 80% i takojnë mallrave industriale (jo-ushqimore) dhe 20% i takojnë mallrave me përbërje bujqësore, industriale ushqimore dhe pijeve (Tabela 10 dhe 11).

Tabela 10: Eksportet e produkteve bujqësore në CEFTA, (2019-2022 në milion euro)

Seksionet/Sektori produkteve bujqësore /Viti	2019	2020	2021	2022	↓↑, 2021/20	↓↑, 2022/21
Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	1.1	1.2	2.0	11.4	75%	466%
Produkte bimore	9.3	11.9	13.9	13.5	16%	-3%
Yndyrëra	0.7	1.1	1.4	3.5	25%	152%
Ushqime të përg. pije dhe duhan	27.2	26.9	34.7	37.1	29%	7%
Total	38.4	41.1	51.9	65.5	26%	26%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Sa i përket bilancit tregtar për mallrat bujqësore Kosovë-CEFTA, importet e mallrave bujqësore tejkalojnë eksportet që do të thotë se bilanci rezulton me deficit të lartë tregtar. Gjatë viteve 2019 - 2022 ka pasur një rritje të eksporteve bujqësore (në total për kapitujt 0 - 24), duke variuar nga 26% deri në 35 %. Mallrat bujqësore me destinacion vendet e CEFTA-s, kanë shënuar rritje në vitin 2022 për 26% në raport me vitin 2021 që është një rritje e ngjashme edhe në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 (26%) ndërsa rritje për 35% në 2021 në raport me vitin 2019.

Produktet bimore dhe Ushqime të përgatitura dhe pije mbeten një potencial i konsiderueshëm për të rritur nivelin e eksportit. Këtë e tregon tabela nr. 10 për eksportet sipas kategorizimit të mallrave bujqësore/sectorët ku shihet se kemi një rritje të eksporteve për produkte bimore dhe sektorin e produkteve ushqimore dhe pijet.

Duke iu referuar tabelës nr.11 mund të vërehet se metalet bazë dhe artikujt prej tyre dominojnë si produktet më të eksportuara në vendet të CEFTA me rreth 130.3 milion € në vitin 2022, pasuar nga produktet minerale me vlerë prej 36.8 milion € si dhe eksporti nga industria e plastikës, gomë dhe artikuj prej tyre 26.3 milion € eksport.

Totali i eksporteve për produkte industriale në drejtim të CEFTA është 268 milion € një rritje prej 18% në raport me vitin 2021.

Tabela 11: Eksportet e produkteve industriale në CEFTA, (2019 – 2022 në milion euro)

Sektori produkteve industriale / Viti	2019	2020	2021	2022	↓↑, 2022/19	↓↑, 2022/21
5 Produkte minerale	15.37	11.26	20.8	36.8	139.4%	77.3%
6 Produkte te industrisë kimike	4.96	6.31	7.7	8.2	64.5%	6.3%
7 Plastik gome dhe artikujt prej tyre	15.42	16.12	20.5	26.3	70.9%	28.7%
8 Lëkure dhe artikuj prej tyre	2.47	2.01	3.9	3.1	23.9%	-20.9%
9 Druri dhe artikujt prej druri	1.97	1.72	3.6	5.4	175.1%	48.8%
10 Letër dhe artikujt prej letrë	3.86	3.66	6.3	8.9	130.1%	41.2%
11 Tekstil dhe artikuj tekstili	2.3	3.09	3.6	4.1	80.4%	13.8%
12 Veshmbathje te këmbëve	0.48	0.91	0.9	0.8	65.5%	-14.0%
13 Art prej guri allçie prod qeramike dhe qelqi	4.06	5.05	9.8	13.9	242.6%	41.9%
14 Perla gurë te çmuar metale te çmuara etj	0	0.01	0.0	0.0	0.0%	-70.8%
15 Metale baze dhe artikujt prej tyre	60.89	100.35	125.3	130.3	114.0%	4.0%
16 Makineri pajisje mekanike dhe elektrike	8.31	8.91	11.7	15.3	84.0%	30.3%
17. Mjete e transportit	1.34	1.97	1.9	2.5	85.5%	32.9%
18 Inst optike mjekësorë fotog muzikore etj	0.12	0.28	0.2	0.4	201.2%	57.7%
19 Armët dhe municioni	0	0	0.0	0.0	0.0%	0.0%
20 Artikujt te ndryshëm te prodhuar	4.87	7.92	10.3	12.1	147.8%	17.1%
21 Veprat e artit	0	0.01	0.0	0.0	0.0%	-42.3%
Total	126.4	169.57	226.5	268.0	112.0%	18.3%

Në tabelën nr. 12 është paraqitur bilanci tregtar për vitin 2022 në mes të Kosovës dhe vendeve të CEFTA të ndara sipas seksioneve, ku vërehet deficitin tregtar pothuajse në të gjithë sektorët e produkteve, si ato të bujqësore ashtu edhe ato industriale. Megjithatë, në sektorin lëkurë dhe artikuj prej tyre kemi bilanc tregtar pozitiv.

Tabela 12: Shkëmbimet Tregtare me vendet CEFTA 2022 (në milion euro)

Sektori produkteve/Indikatori	Eksport	Import	Bilanci Tregtar
Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	11.4	28.9	-17.5
Produkte bimore	13.5	76.6	-63.1
Yndyrëra	3.5	27.8	-24.3
Ushqime të përg. pije dhe duhan	37.1	180.9	-143.8
Produkte minerale	36.8	212.8	-176.0
Produkte të industrisë kimike	8.2	61.3	-53.1
Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre	26.3	45.5	-19.1
Lëkurë dhe artikuj prej tyre	3.1	0.1	3.0
Druri dhe artikuj druri	5.4	34.5	-29.1
Letër dhe artikuj prej letre	8.9	27.0	-18.1
Tekstil dhe artikuj tekstili	4.1	4.3	-0.1
Veshe mbathje të këmbëve	0.8	2.2	-1.4
Art.prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi	13.9	25.5	-11.6
Perla, gurë të çmuar, metale të çmuara	0.0	0.0	0.0
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	130.3	222.1	-91.8
Makinëri, pajisje mekanike dhe elektrike	15.3	30.8	-15.5
Mjetet e transportit	2.5	0.5	2.0
Instr.optike,mjekësore,fotog.,muzikore	0.4	0.3	0.1
Armët dhe municionet	0.0	0.3	-0.3
Artikuj të ndryshëm të prodhuara	12.1	19.1	-7.0
Veprat e artit	0.0	0.2	-0.2
Total	333.6	1,000.7	-667.1

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

• Tregtia e mallrave – produktet e eksportuara dhe importuara

Qasja në tregjet e jashtme është përcaktues vendimtar i performancës së eksportit. Transformimi i thellë rregullator që ka ndodhur në sistemin global të tregtisë që intensivisht promovon liberalizimin e tregtisë qoftë në mënyrë të njëanshme ose të negociuar, rrit urgjencën për vendet e vogla që të përmirësojnë me shpejtësi aftësitë e tyre për të qenë në gjendje të konkurrojnë në mënyrë efektive në ndryshimin e mjedisit tregtar.

Në mjedisin e tanishëm tregtar vendet do të duhet të garojnë çdo ditë e më shumë në baza të barabarta kryesisht në bazë të produktivitetit, çmimit, cilësisë dhe dallimeve në produkte. Elementi vendimtar që shpjegon performancën pozitive të eksportit ose mungesën e suksesit të tij janë kapacitetet në anën e ofertës. Do të thotë aftësia e një vendi për të prodhuar produkte të larmishme në vëllime të nevojshme që të arrihet ekonomia e shkallës dhe të plotësohen kërkesat dhe me cilësi të duhur të përmbushen kërkesat teknike dhe sanitare për ta kënaqur shijen e konsumatorit. Po ashtu është evidente se faktori përcaktues që shpjegon eksportin e


dobët të performancës së mallrave janë kufizimet në anën e ofertës. Kosova po vuan nga një deficit kronik i tregtisë së mallrave, i cili lidhet me kufizimet nga ana e ofertës.

Diversifikimi i eksportit pasqyron shkallën në të cilën eksportet e një vendi shpërndahen përmes një numri të madh produktesh dhe/ose partnerësh tregtar. Kjo është e kundërta e përqendrimit të eksportit, ku fokusi më i madh i tregtisë është në numër mjaft të vogël të produkteve dhe/ose partnerëve tregtar. Një vend ka eksporte më të larmishme kur ka bazë të gjerë të produkteve të eksportuara dhe partnerë tregtarë. Në përgjithësi, eksportet e Kosovës nuk kanë qenë të shumëllojshme dhe ishin kryesisht të përqendruara në produkte metalike dhe mineraleve me vlerë të ulët të shtuar, e cila është karakteristikë e strukturës së dobët ekonomike. Për shumë e shumë vite produktet nga kategoria e metaleve bazë dhe mineraleve kanë qenë më të eksportuarat që përbënin nga 70% me mesataren e viteve 2010 - 2015 e të gjitha eksporteve në nivel vendi. Krahësuar me mesataren e viteve të fundit metalet bazë kanë shënuar ulje të dukshme. Kjo ulje është e shoqëruar me përmirësimet e produkteve nga industria e plastikës dhe industria ushqimore të cilët kanë kontribuar në një bazë eksporti të shpërndarë disi më “të barabartë” në vitet e fundit edhe pse akoma anon shumë nga industritë me bazë metali.

Vlen të përmendet se në terma absolute eksportet, në të gjithë krerët, kanë shënuar normë vjetore pozitive të rritjes (tabela:17).

Kosova është importuese neto e produkteve bujqësore dhe e ka mbajtur deficitin tregtar në rritje të vazhdueshme. Andaj, edhe pse ndër vite kompanitë prodhues kanë rritur aftësitë e prodhimit në këtë mënyrë edhe të eksportit në të njëjtën kohë janë shumëfishuar edhe mallrat e importuara. Megjithatë, gama e mallrave të prodhuara nga kompanitë kosovare ende është e kufizuar nuk është e shpërndare dhe është mjaft homogjene. Struktura e eksporteve në përgjithësi për vite të tëra ka qenë pothuajse e njëjtë. Si sektorë me potencial eksportuese konsiderohet të jetë sektori i metaleve, mineraleve, plastikës, produkteve bimore, sektori i industrisë ushqimore etj. (Figura 6). Sidoqoftë, nga analiza e strukturës së mallrave sipas llojit të produktit më të eksportuar të Kosovës, kuptuam se mbështetëset dhe mbajtëset e dyshekëve

Figura 6. Top sektorët eksportues 2022



prin në top mallrat më të eksportuara.

Vlera eksportuese e tyre ka kaluar nga 26 milion € sa ka qenë në 2020 ka arritur në 123.3 milion € në 2021 dhe se fundi në vitin 2022 ka kaluar në vlerën prej 134.9 milion €. Pjesëmarrja e saj në eksportet e përgjithshme të Kosovës në nivel produkti është afër 15%

rritje për 9.4% krahas vitit 2021. Energjia elektrike eksportuar më së shumti ku pjesëmarrja në eksportet e 7%, rritje prej 53.2 milion €.

mbetet njeri ndër produktet që është përgjithshme të Kosovës është afër

Tabela 13: Produktet kryesore të eksportuara në nivelin e eksporteve të përgjithshme në mil € (HS – 4)

Kodi/ Produkti	2021	2022	Diferenca	↓↑, 22/21	Pjesëmarrja 2022
	Vlera	Vlera	Diferenca	%	%
9404:Mbështetëset dhe mbajtëset e dyshekëve	123.3	134.9	11.5	9.4%	14.7%
2716:Energji Elektrike	10.0	63.2	53.2	529.5%	6.9%
3925:Pajisjet e ndërtimit prej plastike	29.6	49.6	20.0	67.5%	5.4%
7306:Tuba, tubacione dhe profile të tjera prej gize dhe çeliku	36.9	42.8	5.9	16.0%	4.7%
7204:Kthime dhe mbetje ferrike	36.2	41.0	4.8	13.1%	4.5%
3921:Pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjera, prej plastike	13.7	28.1	14.4	105.0%	3.1%
9403:Mobilieri të tjera dhe pjesët e tyre	19.2	25.1	5.9	30.8%	2.7%
2202:Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar	21.4	24.4	3.0	14.1%	2.6%
3923:Artikujt për mbajtjen apo paketimin e mallrave, prej plastike	15.9	19.2	3.3	20.9%	2.1%
7308:Strukturat dhe pjesët e konstruksioneve prej hekuri ose çeliku	11.4	19.2	7.7	67.7%	2.1%

Burimi: ASK, kalkuluar nga DPT

Në vitet e fundit kemi një rritje të vlerës së eksportit për prodhimet bujqësore dhe ato të industrisë agro-përpunuese. Megjithatë Kosova ende vazhdon të importoj sasi të madhe të produkteve bujqësore andaj është më se e nevojshme të ulet varësia e ekonomisë nga importi nëpërmjet nxitjes së prodhimit vendor. Pavarësisht nivelit të rritjes jo shumë të lartë e shprehur në vlera ato mbeten si burime të mëdha për prodhim si dhe potencial të rritjes dhe qëndrueshmërisë ekonomike.

Produktet bimore dhe produktet industriale ushqimore si dhe pijet mbeten një potencial i konsiderueshëm që do të ndihmoj në përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e përparësive konkurruese. Sido që të jetë Kosova ende vazhdon të importoj sasi të madhe të produkteve bujqësore, për pasojë edhe kërkesa për konsum vendor për prodhime bujqësore të përpunuara dhe të papërpunuara plotësohet kryesisht nga importet.

Duke ju referuar të dhënave statistikore dhe analizës së tyre, shifrat tregojnë se për kategorinë e produkteve bujqësore kemi një deficit të lartë tregtare. Gjatë vitit 2022 eksportet e produkteve bujqësore llogariten 118.9 mil euro. Importet shënuan vlerën prej 1miliard e196 mil euro.

Tabela 14: Eksporti i produkteve bujqësore (në milion €)

Seksionet/Viti	2020	2021	2022	2022/2021	↓↑, 2022/21
Emërtimi	Vlera	Vlera	Vlera	Diferenca	%
Kafshë të gjalla, prod me origjinë kafshe	1.29	2.2	11.6	9.4	424.8%
Produkte bimore	31.79	31.9	33.3	1.4	4.3%
Yndyrëra	1.43	1.7	4.5	2.8	167.0%
Ushqime të përg. pije dhe duhan	43.56	57.7	69.6	11.8	20.5%
Total	78.07	93.6	118.9	25.4	27.1%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Produktet bujqësore që klasifikohen në sektorin e industrisë së ushqimit dhe pijeve si dhe produktet bimore mbeten një potencial i konsiderueshëm për të rritur vlerën e prodhimit në këtë kontekst edhe nivelin e eksportit të cilët kanë shënuar rritje për vite të tëra. Eksporti i produkteve të industrisë së ushqimit dhe pijeve ka shënuar një rritje për afër 21% (apo 11.8 milion euro me tepër), eksportet e kësaj industrie kapin shumen prej 69.5 milion Euro, (Tab

14). Kategoritë e mallrave bujqësore që dominojnë me përqindje më të lartë të eksporteve ndaj totalit të eksporteve bujqësore janë: Ujerat, ujerat minerale dhe të gazuara (21% e totalit të eksportit të mallrave bujqësore) apo 2.6% pjesëmarrja në eksportet e përgjithshme të Kosovës (Tab 16) .

Tabela 15: Total eksporti i produkteve bujqësore dhe Industriale mil €

Viti	2019	2020	2021	2022
Produktet Bujqësore	65.5	78.1	93.6	118.9
Produktet Industriale	317.9	396.8	662.1	801.4

Tabela 16:Top 10 produktet bujqësore më të eksportuara mil €

Viti	2021	2022	2022/21	↓↑, 21	2022/	Pjesëmarrja 2022
Kodi/ Produkti	Vler a €	Vler a €	Diferenca €	%		%
2202:Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar	21.4	24.4	3.0	14.1%		2.6%
2203:Birrë e bërë nga malti	10.0	8.3	-1.7	-16.9%		0.9%
1602:Mish tjetër i përgatitur ose i konservuar, të brendshmet e mishit	3.1	6.7	3.5	113.9%		0.7%
0202: Mishi i gjedheve, i ngrirë	0.2	5.3	5.1	2,508%		0.6%
0901:Kafe	3.9	5.2	1.2	31.8%		0.6%
0709:Perime leguminoze	2.5	4.6	2.1	82.2%		0.5%
2204:Verë prej rrushit të freskët	4.2	4.4	0.2	5.4%		0.5%
0810:Luleshtrydhet e freskëta, mjedrat, manaferrat, rrush, manaferrat dhe frutat e tjera	7.0	4.4	-2.6	-36.8%		0.5%
0811:Fruta dhe arra	3.8	4.3	0.4	11.4%		0.5%
2005:Zarzavate të tjera të përgatitura	3.2	4.2	1.0	31.3%		0.5%


Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Me prodhime bujqësore Kosova ka një deficit të lartë tregtar, e cila lë të kuptojë për një strategji më të gjerë për të zhvilluar konkurrencën në ekonomin e lirë si dhe përpjekjet për ngritjen e cilësisë, promovimin e eksportit në kontekstin e krijimit të kushteve për të inkurajuar zhvillimin e një baze ekonomike të diversifikuar, me produktivitet të lartë dhe me vlerë të shtuar.

Po ashtu, referuar vitit 2022, të dhënat statistikore tregojnë se produktet bujqësore përfaqësojnë 12% të vlerës së eksporteve të përgjithshme, ndërsa importet e produkteve bujqësore mbulojnë 21% të importeve të përgjithshme të Kosovës.

Përkritazi me këtë tregu vendor edhe për produkte bujqësore është i varur nga importi dhe për këtë shpenzohet miliona euro në vit.

Figura 7. Eksporti dhe importi i produkteve të bujqësor (000€)



Gjendje e bilancit të importit të produkteve bujqësore reflekton në ekonominë e Kosovës, duke ndikuar negativisht në bujqësi, në industrinë e përpunimit të ushqimit, në krijimin e industrive të reja dhe në sektorët të tjerë prodhues. Mesatarisht, 55% e produkteve bujqësore me origjinë nga Kosova kanë qenë të orientuara në tregjet e rajonit përkatësisht në CEFTA. Sasia e eksportuar është ende

relativisht e vogël dhe ato janë në gjendje të sigurojnë vetëm një pjesë të vogël të kërkesës jashtë tregut vendor për produkte të tilla. Për këtë shkak edhe kërkesa për konsum vendor për produkte bujqësore të përpunuara dhe të papërpunuara plotësohet kryesisht nga importet. Statistikat për tregtinë e jashtme, referuar sistemit të harmonizuar – seksioneve, na tregojnë një pasqyrë të qartë për strukturën eksporteve dhe gjendjen e sektorëve prodhues në Kosovë, për më shumë shih tabelën 17.

Tabela 17: Eksportet sipas seksioneve 2021 – 2022 (milion euro)

Viti	2021	2022	2022/2021	↓↑, 2022/21
Sektorët	Vlera	Vlera	Diferenca	%
1 Kafsh të gjalla produkte me origjin kafshe	2.2	11.6	9.4	424.8%
2 Produkte bimore	31.9	33.3	1.4	4.3%
3 Yndyrera	1.7	4.5	2.8	167.0%
4 Ushqimet të përgjithshme dhe duhan	57.7	69.6	11.8	20.5%
5 Produkte minerale	44.9	104.0	59.0	131.4%
6 Produkte të industrisë kimike	17.6	20.4	2.8	15.9%
7 Plastik gome dhe artikujt prej tyre	80.4	127.9	47.4	59.0%
8 Lëkurë dhe artikujt prej tyre	7.8	9.4	1.6	21.1%
9 Druri dhe artikujt prej druri	10.2	15.6	5.4	52.4%
10 Letër dhe artikujt prej letre	7.6	11.2	3.6	47.9%
11 Tekstil dhe artikuj tekstili	25.7	31.6	5.8	22.6%
12 Veshmbathje të këmbeve	4.1	4.2	0.1	3.4%
13 Art prej guri allçie prod qeramike dhe qelqi	19.2	30.4	11.2	58.2%
14 Perla gure të çmuara metale të çmuara etj	3.9	9.0	5.0	127.7%
15 Metale baze dhe artikujt prej tyre	244.2	212.7	-31.4	-12.9%
16 Makineri pjesë mekanike dhe elektrike	30.8	30.8	0.1	0.2%
17. Mjete të transportit	7.3	11.1	3.9	53.3%
18 Inst optike mjeksore fotograf muzikore etj	1.4	3.1	1.7	118.0%
19 Armet dhe municioni	0.0	0.0	0.0	#DIV/0!
20 Artikujt të ndryshëm të prodhuar	156.8	179.7	23.0	14.6%
21 Veprat e artit	0.2	0.3	0.1	28.1%
Total	755.7	920.4	164.7	21.8%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Në strukturën e mallrave importuese, në nivel produkti, në top mallrat më të importuara prinë Vajrat e naftës. Vlera importuese e tyre ka kaluar nga 385 mil Euro sa ka qenë në 2021 në 686.9 mil Euro në 2022. Pjesëmarrja e tyre në importet e përgjithshme të Kosovës është 12%, pasuar nga auto veturat, energjia elektrike, shufra çeliku, cigare, ujërat, medikamentet etj. Tabela nr. 18.

Tabela 18: Produktet kryesore të importuara në nivelin e importeve të përgjithshme(milion euro)

Viti	2021	2022	2022/21	↓↑, 2022/ 21	Pjesëmarrja 2022, %
Kodi/ Produkti	Vlera	Vlera	Diferenca	%	%
2710:Vajrat e naftës	385.1	686.9	301.8	78.4%	12.2%
8703::Autovetura dhe mjete të tjera transporti	298.0	300.7	2.8	0.9%	5.3%
2716:Energji elektrike	114.0	218.2	104.2	91.3%	3.9%
7214:Shufra dhe shkopinj të tjerë prej gize dhe çeliku	130.1	158.4	28.3	21.7%	2.8%
2402:Puro, cigare dhe cigarillos	87.0	101.2	14.2	16.4%	1.8%
2202:Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar	81.1	94.2	13.1	16.2%	1.7%
3004:Medikamentet	85.6	79.8	-5.8	-6.7%	1.4%
0207:Mishi dhe të brendeshmet e ngrënë	54.6	77.8	23.3	42.6%	1.4%
1905:Bukë, torte, kek, biskotat dhe produkte të tjera	63.2	73.8	10.5	16.7%	1.3%
0102:Gjedhe të gjalla	47.7	67.8	20.1	42.1%	1.2%

Burimi: ASK, kalkuluar nga DPT

Tab.19: Importi i produkteve bujqësore (milion euro)

Viti	2021	2022	2022/2021	↓↑, 2022/21
Emërtimi \ Seksionet	Vlera	Vlera	Diferenca	%
1 Kafshë të gjalla produkte me origjinë kafshe	198.6	280.2	81.6	41.1%
2 Produkte bimore	175.1	201.8	26.7	15.3%
3 Yndyrera	41.6	61.1	19.5	46.9%
4 Ushqimet të përgjithshme dhe duhan	556.0	653.1	97.1	17.5%
Total	971.2	1,196.2	225.0	23.2%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Përkritazi me mallrat bujqësorë vlen të theksohet se në vitet e fundit edhe pse kemi një rritje të eksportit për prodhimet bujqësore dhe ato të industrisë agro-përpunuese, Kosova ende vazhdon të importoj sasi të madhe të këtyre produkteve. Kërkesa për konsum vendor për prodhime bujqësore të përpunuara dhe të papërpunuara plotësohet kryesisht nga importet. Duke ju referuar të dhënave statistikore dhe analizës së tyre, shifrat tregojnë se për kategorinë e produkteve bujqësore kemi një deficit të lartë tregtare mbi 1 miliard euro.

Tab.20: Importet sipas seksioneve 2021-2022 (milion euro)

Viti	2021	2022	2022/2021	↓↑, 2022/21
Seksionet	Vlera	Vlera	Diferenca	%
1 Kafshë të gjalla produkte me origjinë kafshe	199	280.2	81.6	41.1%
2 Produkte bimore	175	201.8	26.7	15.3%
3 Yndyrera	42	61.1	19.5	46.9%
4 Ushqimet të përgjithshme dhe duhan	556	653.1	97.1	17.5%
5 Produkte minerale	629	1,045.5	416.1	66.1%
6 Produkte të industrisë kimike	356	403.0	47.1	13.2%
7 Plastik gome dhe artikujt prej tyre	339	384.2	45.4	13.4%
8 Lëkurë dhe artikujt prej tyre	11	12.5	1.7	16.1%
9 Druri dhe artikujt prej druri	105	124.2	18.9	18.0%
10 Letër dhe artikujt prej letre	64	86.4	22.6	35.5%
11 Tekstil dhe artikujt tekstili	236	267.1	31.3	13.3%
12 Veshmbathje të këmbëve	45	53.9	9.2	20.6%
13 Art prej guri allçie prod qeramike dhe qelqi	163	195.0	32.2	19.8%
14 Perla gure të çmuara metale të çmuara etj	7	9.9	3.1	45.3%
15 Metale baze dhe artikujt prej tyre	519	593.4	74.7	14.4%
16 Makineri pajisje mekanike dhe elektrike	598	624.8	26.6	4.4%

17. Mjete e transportit	451	409.7	-41.7	-9.2%
18 Inst optike mjeksore fotog muzikore etj	56	64.8	8.8	15.8%
19 Armet dhe municioni	6	17.9	12.4	222.6%
20 Artikujt te ndryshëm te prodhuar	126	146.3	19.8	15.7%
21 Veprat e artit	3	4.6	1.8	63.8%
Total	4,684	5,359.2	955.2	20.4%

Burimi: ASK kalkuluar nga DPT

Pra, siç tregojnë edhe analizat e të dhënave të prezentuara struktura e importeve ka mbetur përafërsisht e njëjtë me vitet e mëparshme. Importet vazhdojnë të dominohen nga sektori i mineraleve (lëndë djegës nafta dhe produktet e saj), nga sektori i industrisë ushqimore nga makineritë dhe pajisjet, shih Tab.nr.20.

• Tregtia Globale

Për mirë ose për keq, ne tani jetojmë në një botë ku fjalët "ndërprerje të zinxhirit të furnizimit" zbatohen për një numër të mahnitshëm çështjesh që prekin tregun global. Mungesa e ushqimit, pajisjeve / produkteve tjera, incidentet e katastrofës klimatike, trazira politike, inflacioni, tregu i aksioneve të gjitha mund të lidhen në një farë mënyre me çështjet e vazhdueshme me zinxhirët e furnizimit global.

Sipas Raportit të Bankës Botërore rritja e tregtisë globale u ngadalësua në gjysmën e dytë të vitit 2022, së bashku me përkeqësimin e aktivitetit në ekonomitë kryesore. Dobësimi i tregtisë pasqyroi ngadalësimin e prodhimit industrial global. Pas zbutjes në 4 për qind në 2022, rritja e tregtisë globale pritet të ngadalësohet më tej në 1.6 për qind në vitin 2023 duke reflektuar kryesisht në dobësimin e kërkesave globale. Menaxhimi i tregtisë në skenën globale ka zënë gjithashtu skenën qendrore në fushën e politikës.

Lufta tregtare midis Shteteve të Bashkuara (SHBA) dhe Kinës, tarifave hakmarrëse, sanksionet, inflacioni, paqëndrueshmëria politike, pushtimi i Ukrainës nga Rusia dhe Brexit – të gjitha kanë implikime për tregtinë globale. Natyrisht, disa nga ndikimet më të menjëhershme mund të gjurmohen që nga pandemia, por nisma të tjera politike si Brexiti premtojnë të kenë pasoja që do shtrihen shumë në të ardhme. Sanksionet në lidhje me pushtimin e Ukrainës nga Rusia kanë tronditur tregjet botërore me pasigurinë e zinxhirit të furnizimit dhe luhatjet e çmimeve, duke ndezur inflacionin dhe duke stresuar konsumatorët në mbarë botën.

Shqetësimet në lidhje me disponueshmërinë/ furnizimin e ushqimit për shkak të pushtimit të Ukrainës rezultoi me një numër të vendeve që zbatuan kufizime të eksportit të ushqimit në vitin 2022. Inflacioni i lartë global ka nxitur edhe shtrëngime të njëkohshme të shpejta monetare. Kjo ka ndikuar në përkeqësimin e kushteve financiare, veçanërisht për më pak tregjet në zhvillim dhe ekonomitë në zhvillim të denjë për kredi. Rritja në vitin 2023 pritet të jetë e treta më e dobët në gati tre dekada, nën hije vetëm nga recesionet globale.

Rimëkëmbja e plotë nga recesioni pandemik është larg veçmas në Tregjet në Zhvillim dhe Ekonomitë në Zhvillim (EMDE), dhe perspektiva e të ardhurave për frymë është e nënshtruar veçmas për vendet e goditura nga varfëria.

• Indeksi i varësisë tregtare

Ndikimi relativ i krizës ekonomike në tregtinë ndërkombëtare mund të shihet veçmas në krahasimin e eksporteve dhe importeve si përqindje e bruto prodhimit vendor. Vlera totale e mallrave dhe shërbimeve në tregtinë ndërkombëtare pasqyron integrimin e vendeve në

ekonominë botërore. Vendet e vogla, eksportet e tyre prijnë të jenë në një numër të kufizuar sektorësh dhe atyre u duhet të importojnë më shumë mallra dhe shërbime se sa vendet më të mëdha për të kënaqur kërkesën e brendshme.


Figura 8: Indeksi i Varësisë Tregtare 2010-2022



mat raportin e tregtisë me vlerën e Prodhimit Brendshëm Bruto, jep një pasqyrë për shkallën e hapjes së vendit në raport me botën. Nga figura 8 mund shihet se si rritja e shkëmbimeve tregtare, pra rritja e vlerës së importeve dhe eksporteve, sidomos në vitin 2021 dhe 2022 ka ndikuar që ky indikator të ketë një ndryshim nga mesatarja prej 54% për vitet 2012-2020 në 68% në vitin 2021 si dhe 73% në vitin 2022. Megjithatë vlen të ceket se këtu kemi të bëjmë me një përllogaritje të vlerës së tregtisë së jashtme në raport me BPV, andaj rezultati i kësaj përqindje detyrimisht është i ndërlidhur me rritjen e çmimeve globale përkatësisht me inflacionin e importuar.

Indeksi i tendencës së eksporteve

Figura 9 : Indeksi i tendencës së eksporteve 2010-2022




Situata aktuale e eksportit në Kosovë dhe deficiti i lartë tregtar pasqyrojnë një nivel të ulët të konkurrencës në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm si dhe mungesës së llojllojshmërisë së produkteve. Mallrat e eksportuara përbëjnë rreth 10.3% të BPV (për më tepër figura 9), dhe janë të përqendruara në sektorët me komponentë të ulët të vlerës së shtuar, në veçanti metalet dhe mineralet. Kjo strukturë paraqet një sërë problemesh të mëdha për ekonominë kosovare. Ajo tregon një mungesë masive të qëndrueshmërisë afatgjatë, duke e bërë atë të varur nga çmimi i tregut ndërkombëtar etj. Deficiti i lartë tregtar pasqyron një bazë të pazhvilluar dhe të ngushtë të prodhimit vendor. Kompanitë që konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare janë të ekspozuara nga konkurrenca më e lartë për produkte nga prodhimet e jashtme. Hyrja në tregje të reja dhe gjetja e kërkesës për një produkt të ri mbetet sfida për sektorin prodhues vendor. Indeksi i tendencës së eksportit tregon shkallën e mbështetjes së prodhuesve vendas në tregjet e huaja. Një Indeks i tendencës së eksporteve më e lartë do të nënkuptojë një tendencë më të lartë të prodhuesve vendas për të eksportuar produktin në tregun e huaj në krahasim me shitjen në tregun vendas. Kjo do të thotë gjithashtu se ka pranim të produktit tuaj nga vendi juaj në tregjet ndërkombëtare.

Megjithëse shumë vende përpiqen të diversifikojnë eksportet e tyre, bujqësia dhe burimet natyrore ende përfaqësojnë një pjesë të madhe të shportës së eksportit të shumë vendeve në zhvillim. Nga indeksi i vrasisë tregtare e cila

Situata aktuale e eksportit në Kosovë dhe deficiti i lartë tregtar pasqyrojnë një nivel të ulët të konkurrencës në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm si dhe mungesës së llojllojshmërisë së produkteve. Mallrat e eksportuara përbëjnë rreth 10.3% të BPV (për më tepër figura 9), dhe janë të

Indeksi i mbulimit të eksportit/importit

Figura 11 : Indeksi i mbulimit eksport/import 2010 – 2022



Meqenëse arsyeja kryesore për importimin e produkteve është plotësimi i kërkesës për mallra që nuk mund të prodhohen në vend, andaj importohet një kategori e gjerë e mallrave pasi që prodhimi vendor është i limituar.

Ndërkohë që rritja e çmimeve ka pasur pa diskutim efekt të dukshëm në shifrat e tregtisë së

jashtme, si në eksport ashtu edhe në import, nga ana tjetër sipas të dhënave norma e mbulimit, pra pesha që zënë eksportet ndaj importeve në vitin e krizës globale 2022 është 16.3%. Kosova importon shumë më shumë se që eksporton, ecuria e kësaj dukurie nga viti 2010 – 2022 është paraqitur në figurë 11.

Mundësia për ta zvogëluar deficitin tregtar dhe ndikimin e saj në BPV është shumë e kufizuar.

• Pengesat strukturore

Evidente është se deficitin e qëndrueshëm dhe në rritje të tregtisë së mallrave përbën një sfidë të madhe për ekonominë e Kosovës. Stabiliteti dhe shkalla e mbijetesës së eksporteve të Kosovës, si në nivel të produktit, ashtu edhe të firmës është mjaft e dobët. Në mënyrë që diversifikimi i eksportit të jetë i suksesshëm, duhet të jetë e qëndrueshme përfshirja e produkteve të reja në pakon eksportuese. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet furnizuesve vendor dhe regional ndalon krijimin e lidhjeve midis kompanive ndërkombëtare.

Një integrim eventual i furnizuesve kosovar të inputeve në zinxhirët regional të furnizimit do të krijonte efekte të përhapjes vertikale. Kufizimet në infrastrukturën e cilësisë dhe në aftësitë për të administruar masat sanitare dhe fito sanitare, barrierat teknike në tregti, integrimi i kufizuar në zinxhirin e vlerave janë elementet përcaktuese që kufizojnë mundësitë e tregtisë së Kosovës.

Mungesa e të dhënave për tregun, mungojnë burime të institucionalizuara, të cilat ofrojnë informacione sistematike, të besueshme dhe të arritshme në lidhje me tregun. Globalisht e gjithë industria prodhuese po ndryshon, shumë vende të zhvilluara dhe kryesisht ato me ekonomi të mëdha, do të jenë përcaktues të hapave që duhen ndërmarrë drejt të ardhmes së teknologjisë digjitale, kështu që digjitalizimi dhe industritë transformuese gjithashtu do të ndikojnë edhe në industrinë e Kosovës.